

VENDIM
Nr. 204, datë 13.3.2013

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMET E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 1265, DATË 16.12.2009 “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË DELVINË TË QARKUT TË VLORËS”, DHE NR. 250, DATË 24.4.2003 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË RENDIT PUBLIK”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të bashkisë së Delvinës të pronës me numër rendor 279, me emërtesë “Ish-Komisariati i Policisë, Delvinë, lagjja “Sinan Ballaci”, Delvinë”.

2. Në listën, që i bashkëlidhet vendimit nr. 250, datë 24.4.2003 të Këshillit të Ministrave, hiqet prona me emërtesë “Ish-Komisariati i Policisë, Delvinë”, me sipërfaqe totale të pronës 546 (pesëqind e dyzet e gjashtë) m², e me sipërfaqen e ndërtesës 108 (njëqind e tetë) m², sipas formularit bashkëlidhur, e cila i shtohet listës që i bashkëlidhet vendimit nr. 1265, datë 16.12.2009 të Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia e Delvinës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha